



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:110106
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06104448

P.nr.571/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurit: F.I., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.343/2019 të datës 22.05.2019, jashtë seance, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 106 par.1 nën par 1.5, nenit 107 par.8 të KPRK-së dhe nenit 357 par.1 nën par .3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (*tutje: KPP*), më datë 30.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.343/2019 të datës 22.05.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: F.I., nga i ati R....., e ëma Sh....., e vajzërisë A....., i lindur me datë 08.03.1983 në T.... – L....., me vendbanim në rr. “.....”, p.n., Mitrovicë, i papunë, bashkëjeton, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale.
2. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
3. Pala e dëmtuar Bashkim Shkreli, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.343/2019 të datës 22.05.2019, ndaj të pandehurit F.I., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e çështjes, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare përkitazi me afatin e parashkrimit, ka konstatuar se në këtë lëndë penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të pandehurin F.I., sa i përket veprës penale të lartëcekur.

Sipas aktakuzës, i pandehuri është akuzuar nën dyshimin se ka kryer veprën penale: Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale sipas KPRK-së (ligj ky në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale) është përcaktuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se i pandehuri, veprën penale, dysohet ta ketë kryer me datë 29.08.2018 dhe që nga ajo kohë (koha e kryerjes), e deri tani kanë kaluar më tepër se gjashtë (6) vite.

Në nenin 106, par.1, nën par 1.5 të KPRK-së, është përcaktuar se “*ndjekja penale nuk mund të ndërmerret kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim*”. Ndërsa neni 107, par. 8, i të njëjtit Ligj, përcakton se “*ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit*”.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nga kryerja e veprës penale e deri më tani ka kaluar më shumë se dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit çka do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 107 par. 8 të KPRK-së, sepse brenda kësaj periudhe kohore nuk ka përfunduar ndjekja penale. Saktësisht, parashkrimi absolut i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 29.08.2024.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, e ka hedhur akuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata e mbështet në nenin 462 par.3 të KPP-së.

Andaj, gjykata në bazë të lartcekurave e konform nenit 357 par.1 nën par. 1.3 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.571/2019, dt:30.08.2024

G j y q t a r j a
Benita Berisha

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.